



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional në
“Menaxhim”
i
Institucionit të arsimit të lartë “Universiteti European i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Dr. Vita KOJA

2. Dr. Ana Buhajjoti

Shtator/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit me karakter profesional në “Menaxhim”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi me karakter profesional në “Menaxhim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 554 datë 11.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Nuk ka, akreditim për herë të parë
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2020-2021):	19 PAE
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	(36+93+24) = 153
19	Komente / të tjera:	



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter Profesional "Menaxhim" ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit pranë Universitetit Europian të Tiranës (UET).

Insitucioni i Arsimit të Lartë, jopublik, "Universiteti Europian i Tiranës", është krijuar me Vendimin Nr.636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës" si dhe të programeve të Studimit të Ciklit të Parë". "Universiteti Europian i Tiranës" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA.

Ky program studimi është hapur Urdhërin e MASR nr. 554, datë 11.09.2018 dhe realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), me formë studimi me kohë të plotë në përfundim të të cilit lëshohet diploma profesionale në "Menaxhim" referuar nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Duke u mbështetur në kuadrin ligjor të krijuar me ndryshimet në legjislacionin e ri për arsimin e lartë, të rrjedhura nga Ligji Nr 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ky program studimi ka nisur në vitin akademik 2018-2019, dhe ofrohet nga departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit i riorganizuar ky i fundit me Urdhërin e MASR Nr.527, datë 04.09.2018.

Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës. Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon t'u ofrojë studentëve njohuri teknike të aplikuara në menaxhim, si dhe pajisjen me instrumentat themelorë për rritjen e aftësive në menaxhimin operacional të bizneseve.

Programi i studimit me karakter Profesional "Menaxhim", plotëson përgjithësisht kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e tregut të punës dhe ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga një staf i kualifikuar, sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe plotësimit të burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit.

Rëndësia e këtij programi lidhet me fushën e Menaxhimit që po zhvillohet sot brenda ekonomisë dhe biznesit dhe kërkon specialist të pajisur me njohuri profesionale e aftësi praktike për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut në shumë sektorë. Studentët e diplomuar priten të jenë specialistë teknik, që do të plotësojnë nevojat e tregut shqiptar në disa sektorë, kryesisht shërbime, të cilat po rriten shpejt në kohët e sotme.

Programi është në përputhje me reformën e arsimit të lartë për rritjen e kapaciteteve njerëzore në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me kërkesën për profesionistë operacional të aktiviteteve ekonomike jo vetëm brenda vendit, por dhe në tregjet në rritje rajonale e globale.

Përmes lancimit të këtij programi dhe tashmë testimit të tij në treg, ky program rrugëton dhe mbështet mundësinë e profilizimeve dhe aftësive të tjera me të specializuara që mund të



ofrohen në të ardhmen nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET dhe mund të përbëjnë një bazë të mirë për zhvillim në të ardhmen, nëse shfrytëzohen si duhet.

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat lidhur me përbërjen e stafit, titujt akademikë dhe ngarkesën e personelit akademik. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit me karakter Profesional "Menaxhim" dhe të zhvillimit të institucionit. Institucioni zotëron të dhëna të sakta për veprimtarinë e kualifikimit të vazhdueshëm profesional.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Projekteve mat ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorët për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të UET dhe Rregullores së Programit.

Në regjistrin e administruar nga sekretaria mësimore e institucionit janë pasqyruar të dhënat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, e cila u verifikua dhe me vizitën e GVJ bazuar në një përzgjedhje të rastësishme.

Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e këtij programi përmes sistemit të komunikimit të brendshëm, ku çdo student ka hapësirë vetjake të dedikuar përmes të cilit informohet e ka akses në dokumentacionin elektronik. GVJ konstatoi se përmes sektorit të Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve. ***GVJ rekomandon një përpjekje më të madhe të institucionit në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin aktualisht.***

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese lokale për të krijuar një lidhje organike me tregun e punës në funksion të programit të studimit.

Programi i studimit me karakter Profesional "Menaxhim" mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në Menaxhim. Kjo është një mundësi për lidhjen e studentëve me një sektor apo profesion që në ciklin e parë të studimit. Por nga ana tjetër paraqet një sfidë për realizimin e një formimi sa më profesional e teknik vetëm me një numër dhe ngarkesë të kufizuar të lëndëve në praktikë dhe raportin e ulët të praktikës kundrejt teorisë në profilin Menaxhim. ***GVJ rekomandon që njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin e Menaxhimit në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit. Kjo kërkon dhe një gjurmim real të alumnit në tregun e punës, çka do të ndihmojë në nxitjen e kërkesës së ardhshme për***



këtë program. GVJ rekomandon të rishikohet raporti mes ngarkesës teorike dhe praktike të lëndëve duke vlerësuar si domosdoshmëri rritjen e orëve praktike dhe përshtatjen e kurrikulës sipas karakterit praktik të programit në mënyrë që në dy vjet të pajisë me aftësi teknike e operacionale specialistë në fushën e menaxhimit.

GVJ thekson domosdoshmërinë e konkretizimit të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit. Mbi të gjitha lëndët e profileve duhet të konkretizojnë njohuritë e specializuara të profilit me raste praktike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit me karakter profesional në "Menaxhim" ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trainuan për standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe menaxheri Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë u zbatua me rigorozitet axhenda e takimit date 23 Qershor 2021. GVJ mbledhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit të Biznesit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Edukimit, dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Vita Koja dhe Dr. Ana Buhajoti për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 30/07/2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/55 Prot., datë 30/07/2021, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 13/08/2021 dhe me shkresë zyrtare Nr 78/31 Prot., date 23.08.2021.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Konkretisht:

1. Lidhur me Standardi I.1, Kriteri 6, fq.8: GVJ gjykon se nuk ka ndryshim në raport pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm arsyeton në përputhje me sugjerimin se një bashkëpunim më i konsoliduar njësi, student, institucion, sektor publik dhe privat duhet të bëhet për të përforcuar programin e studimit dhe rritur mundësitë e punësimit të studentëve.
2. Lidhur me komentin në Rubrikën "Të dhëna të përgjithshme të programit të studimit...", fq.3 ka ndryshim nga "GVJ rekomandon një transparencë më të madhe të institucionit në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi" në "GVJ rekomandon një përpjekje më të madhe të institucionit në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi". GVJ ka vlerësuar transparencën e institucionit në këtë pikë me komentin fq 3 "GVJ konstatoi se përmes sektorit të Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve".
3. Lidhur me komentin në "Struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit me karakter profesional" dhe Standardi II.2, Kriteri 4, fq. 19:, GVJ gjykon se nuk ka

ndryshim në raport. Kriteri është përcaktuar nga ASCAL " Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50) dhe 25% e programit i ofron studentit aftësim praktik/punë konkrete në profesion." Referuar Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". GVB ka dhënë vlerësimin e nuk ka një raport të balancuar praktikë -teori. Përsa i përket ngarkesës në kredite dhe raportit leksion/seminar konkretisht në këtë program kemi:

- 420 orë leksione
- 426 orë seminare
- 125 orë praktika profesionale në terren

Pra raporti teori praktike: 420/551, ose 0.7 me 1.

Lidhur me këtë raport, praktika profesionale / punë konkrete në profesion nuk përmbush 25% të programit. GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin.


4. Lidhur me komentin "Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat", Standardi III.1 dhe Standardi III.5 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte dhe as evidenca konkrete që kundërshtojnë vlerësimin. GVJ i qëndron fort vlerësimin në përmirësim të programit të studimit dhe nuk bën përllogaritje matematike, ndryshe do ti vendosnim pesha kriterëve. Vlerësimi i GVJ kriteret plotësohen plotësisht do të ishte në rastin kur do plotësoheshin 100% kriteret.
5. Lidhur me komentin që bëhet për standartin Standardi III.4, Kriteri 2, fq.30., GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin . GVJ mbështet në përforcim të programit mësimor pa ndikuar në vlerësimin përfundimtar të këtij kriteri.
6. Lidhur me komentin që bëhet për standartin 1.5 kriteri 3, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte dhe as evidenca konkrete që kundërshtojnë vlerësimin, dhe GVB bie dakord me sugjerimin e GVJ.

Së fundi vlen të theksojmë se bazuar në dokumenetacion dhe vizita në institucion, GVJ ka bashkëvepruar për të ndërtuar një raport sa më realist dhe ndihmues për institucionin.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Menaxhim”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter Profesional “Menaxhim” është në përputhje me misionin e përgjithshëm të UET për tu siguruar studentëve një edukim cilësor dhe dije të qëndrueshme përmes kërkimit shkencor për ndërtimin e shoqërisë së të ardhmes bazuar në dije. Tek misioni i tij vihet theksi tek elementi i cilësisë së edukimit, shërbimi i shoqërisë përmes dijes, kontributit në kërkim dhe përdorimit të tyre në të mirë të shkencës dhe tregut të punës. Në këtë kontekst duke krahasuar me elementët e programit me karakter Profesional “Menaxhim”, synon përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për punësim në fushën e menaxhimit sipas karakterit operacional të kualifikimit, duke siguruar një arsimim të nivelit të lartë profesional, më dije bashkëkohore për menaxhimin si dhe me njohuri të qëndrueshme në fusha të përafërta, duke ndikuar kështu në zhvillimin e kapaciteteve të menaxhimit në çdo sektor. Programi është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UET, dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë. Vetë institucioni mbështet programin e studimit me karakter Profesional “Menaxhim” me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat janë evidentuar edhe tek qëllimi i programit të studimit dhe bazuar në dokumenta strategjike të institucionit. UET me programin me karakter Profesional “Menaxhim” kërkon të përforcojë njohuritë dhe ekspertizën në fushën e menaxhimit duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet publike, organizatat si dhe me aktorë për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Qëllimi final është të mësuarit më cilësor, i cili shprehet dhe në strategjinë e institucionit. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional “Menaxhim”</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i> <i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në “Menaxhim”. Pdf</i> <i>Evidenca 3: Plani Strategjik UET 2015-2020.pdf</i>



	<i>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.pdf</i> <i>Evidenca 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025.pdf</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi me karakter Profesional "Menaxhim" është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit në fuqi. Në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të UET gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Synimi i UET ka qenë hartimi i programit të studimit me karakter Profesional "Menaxhim" në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplinor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale. Statuti është dokumenti kryesor, prej të cilit hartohen rregulloret dhe procedurat e Fakulteteve dhe Departamenteve dhe organeve të tjera mbi bazën e të cilave zhvillohet e gjithë veprimtaria mësimore, shkencore dhe edukative në UET. Statuti, dhe rregullorja e UET janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standarteve akademike e kërkimore, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për biznesin e nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i> <i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim". Pdf</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësive kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Programi me karakter Profesional "Menaxhim" ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut brenda Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Ky program studimi është hapur me Urdhërin e MASR nr. 554, datë 11.09.2018 dhe realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), me formë studimi me kohë të plotë në përfundim të të cilit lëshohet diploma profesionale në "Menaxhim" referuar nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Programi i studimit lidhur me emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje me drejtimin akademik të institucionit në fushën e ekonomisë e biznesit, si pjesë e këtij fakulteti. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i> <i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim". Pdf</i>

Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	UET ka hartuar planin strategjik 5 vjeçar "2015-2020" pjesë e të cilit është dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. UET përpiqet të mbajë një ekuilibër mes fleksibilitet kurrikular dhe lehtësim të zgjedhjes/përcaktimit të fushës së studimit nga studentët. Përmes programit me karakter Profesional "Menaxhim" UET promovon kërkesën aktuale për ekspertë dhe specialistë të formuar në nivel cilësor në menaxhim në rang kombëtar e ndërkombëtar. Sikurse u evidentua nga Plani Strategjik, Raporti i Studimit të tregut dhe vizita në institucion UET ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës në përputhje me programin e studimit. Nga takimi me Drejtuesen e Departamentit të Biznesit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë GVJ u informua se krijimi dhe përmirësimi i programit është bazuar në studime tregu të realizuara nga GIZ dhe Fondacioni Fridrich Ebert, zyra e Karrierës me synim gjurmimin e studentëve të diplomuar (Alumni) në tregun e punës, duke evidentuar profilet dhe punësimin e tyre, takime me Bordet e Tregut të punës, ku UET ka organizuar takime me grupe ekspertësh, në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë. Vlerë e shtuar për gjurmimin real të studentëve janë dhe evenetet e organizuara si Festivali Alumni dhe Open Weeks-panairi i punës i çdo fakulteti të UET. Zyra e Karrierës kujdeset të gjurmojë në mënyrë periodike punësimin real të studentëve të diplomuar dhe ndjek zhvillimet e në sektorin përkatës përmes marrëveshjeve të ngushta në tregun e punës (evidence nga vizita në institucion). <i>GVJ rekomandon se njësia përgjegjëse e programit të studimit, në bashkëpunim me Sektorin e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës duhet të kujdeset të gjurmojë me rigorozitet punësimin real të studentëve të diplomuar në këtë program studimi dhe të ndjekë zhvillimet në këtë nivel profesional përmes marrëveshjeve të ngushta me tregun e punës. Njësia përgjegjëse e programit duhet të angazhohet më tepër në mundësitë e punësimit të studentëve, të cilat të evidentura statistikisht do ti shërbejnë si avantazh konkurrues i programit dhe si promotor i tij për brezat e ardhshëm të këtij programi.</i>			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Nga RVB dhe takimi në institucion u konstatua se gjatë vitit 2020 nuk janë kryer studime tregu për arsye të rrethanave të shkaktuara nga Covid 19.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	<i>Evidenca 3: Plani Strategjik UET 2015-2020.pdf</i> <i>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.pdf</i> <i>Evidenca 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 16. Studimi i Tregut te punes para hapjes se programit.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e lëndëve/ moduleve bazë të programit mbulohen nga stafi i DMM, ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm për lëndët ndërdisiplinore brenda kurrikulës. Programet në UET janë ndërdisiplinore që lejojnë bashkërendim të stafit ndër disiplina e profile formimi, ku dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut angazhohet në programe studimi të njësive të tjera. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikëqyret nga instancat drejtuese të UET duke filluar nga Zv. Rectori, Zv. Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, Sekretaria, SBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UET-së. <i>Aneksi 1: Rregullore e mësimit të programit. Pdf</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e UET. pdf</i> <i>Evidenca 39: Dokumenti A.III., Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (A.III.5). pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit. Pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, UET ka marrëveshje me palët e treta, institucione e biznese për shkëmbim ekspertize në funksion të procesit mësimor dhe realizimin të objektivave të programit të studimit. Një bashkëpunim të gjerë UET ka me aktorë biznesi brenda vendit, siç u pohua nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit. GVJ i janë vënë në dispozicion 15 marrëveshjet e nënshkruara që u japin mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese. Gjithashtu UET ka krijuar disa marrëveshje bashkëpunimi me Institucione homologe edhe jashtë vendit përmes programit Erasmus+ me objekt shkëmbimin e burimeve njerëzore dhe ndërtimin e programeve të reja të studimit. Nga vizita në institucion GVJ u informua për konkretizimin e planit të bashkëpunimit ndërinstitutional për programin me karakter praktik në Menaxhim me Universitetin Ludwig në Gjermani për zhvillimin e lëndëve plotësuese , praktikës mësimore pranë këtij universiteti i cili ofron program të ngjashëm.

	<i>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të Punës. pdf</i> <i>Evidencat 12.3 Panairi i Punës, 2019, 2019. pdf</i> <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i> <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). Pdf</i>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në fund të vitit akademik, departamenti bën analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku përveç aspekteve të tjera të punës për mbarëvarjtjen e programit të studimit, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera. <i>GVJ konstaton se mungojnë analiza për përfitimet konkrete në funksion të realizimit të programit mësimor me karakter praktik në Menaxhim.</i> <i>GVJ rekomandon bashkëpunime me biznesin në funksion të këtij programi formimi dhe rritjes së aftësive praktike të studentëve për arritjen e qëllimeve të programit të studimit. GVJ sugjeron një angazhim më të madh të Zyrës së Karrierës dhe Njesisë përgjegjëse për të përforcuar praktikën mësimore në planin mësimor të programit me punëdhënës të bizneseve lokale. Nga takimi i GVJ me studentët rezultoi se ata ishin të paorientuar lidhur me praktikën e punës. GVJ kërkon të orientohen studentët drejt aftësive praktike, mënyrës së kërkimit të punësimit më të mirë që u përshtatet me programin e studimit. Gjithashtu, GVJ sugjeron zhvillimin e kurrikulës së studimit drejt këtij komponenti dhe nëse është nevoja të shtohen lëndë operationale për të përgatitur studentët në hapat drejt tregut të punës e kualifikimeve praktike.</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit. Pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	UET ka vendosur në dispozicion të GVJ një dokument me Institucione e kompani në të cilat studentët e programit me karakter profesional "Menaxhim" kanë mundësi të zhvillojnë praktikën e tyre. Vlen të theksohet se një pjesë e studentëve që ndjekin këtë program janë të punësuar dhe praktikën e zhvillojnë në vendin e punës. Procesi mbikëqyrës nga Zyra e Karrierës në bashkëpunim me departamentin dhe pedagogun mbikëqyrës të praktikës. <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i> <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). Pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të	Zyra e Karrierës kujdeset për zgjerimin e bizneseve partnere përmes Panairit të Punës në UET, Festivali Alumni dhe Open Weeks-panairi i

studentëve.	punës i çdo fakulteti të UET. UET ofron trainime me profesionistë të fushës për studentët. Nga takimi me zyrën e Karrierës u evidentua se për këtë bashkëpunohet me punëdhënësit dhe evidentohen fushat specifike të trainimit dhe zhvillimit të karrierës. Zyra e Karrierës së UET është aktive si qendër punësimi dhe zhvillimi karriere për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.


Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit me karakter profesional "Menaxhim" organizohet sipas ligjit, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS. Bazuar mbi dokumentacionin për hapjen e programit të studimit, dokumentat e programit mësimor dhe planit mësimor, dhe rregullore e programit të studimeve, ka një shpërndarje sipas ligjit e moduleve dhe e krediteve, gjithashtu duke parashikuar sipas standarteve orët fizike, orët në auditor (leksione, seminare, praktika mësimore) dhe ato të studimit individual, orë për praktikën në terren ka një ndarje të qartë sipas ligjit e moduleve konkretisht: Lëndë bazë 19 kredite; Lëndë karakterizuese 58 kredite; Lëndë ndërdisiplinore dhe integruese 24 kredite; Lëndë plotësuese dhe praktika e punës 6 kredite; Detyrime përmbysëse, provim formimi 5 kredite; Në rregulloren e programit të studimit paraqitet shpërndarja e lëndëve sipas legjislacionit në fuqi. <i>Aneksi 1: Rregullore e mësimi të programit. Pdf</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e UET. pdf</i> <i>Evidenca 39: Dokumenti A.III., Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (A.III.5). pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit. Pdf</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e	Duke iu referuar programit të studimit, përshkrimit të detajuar të lëndëve, vëmë re se programi nuk garanton specializim të mirëfilltë



njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	teknik e profesional të studentëve të diferencuar nga kurrikula e programit bachelor, pasi orët praktike janë të kufizuara në raport me teorike. <i>Praktika e punës si lëndë plotësuese zë një peshë të ulët për programin me karakter profesional "Menaxhim" çka zbeh përfitimin e aftësive praktike dhe zhvillimin e specialistëve operativ në fushën e menaxhimit. GVJ gjykon se praktika si komponent i veprimtarisë mësimore, ndikon drejtpërdrejtë në shkallën e aftësimin të studentëve, ndaj sugjerojmë të integrohet në çdo lëndë mundësia e aftësimin të studentëve dhe të reflektohet me ndryshimin e orëve në leksion në raport me orët në seminar.</i> Llojshmëria e lëndëve brenda kësaj diplome mbështetet nga llojshmëria e fushave të zgjedhura brenda Menaxhimit, çka garanton njohuri gjithëpërfshirëse. Fakti që ka disa profile të ndërtuara mbi lëndët/modulet ndërdisiplinore u jep mundësi studentëve të specializohen dhe programit të ofrojë një llojshmëri të gjerë specialitetesh. <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Në përfundim të programit 2 vjeçar me karakter profesional në "Menaxhim" studentët pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional e praktik. Programi me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme. Studentët synojnë të pajisen me aftësi dhe kompetenca profesionale dhe teknike të ndryshme për zgjidhur kërkesat që i shtron mjedisi ku do të jetë i punësuar, si dhe për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme. Programi i studimit synon të aftësojë specialiste me tipare fleksibel, të kenë shkathtësi të transferueshme që mund ta përdorin për çdo pozicion që aplikojnë, përshtatshmëri, shkathtësi teknike, aftësi komunikuese por edhe aftësi organizative, menaxheriale, e mbikëqyrëse.
Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	<i>Siç u theksua dhe më lart, GVJ gjykon që shpërndarja e orëve të programit nuk garanton specializim të mirëfilltë teknik e profesional të studentëve sepse orët praktike janë të kufizuara në raport me teorike. Pësha e ulët e praktikës gjithashtu si komponent i veprimtarisë mësimore, ndikon në shkallën e aftësimin të studentëve.</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit pranë UET është njësia kryesore, e strukturuar për të ofruar programe studimi në tre ciklet,



bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.	bachelor, master, doktoraturë, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë dhe bazuar mbi Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Bazuar në evidencën e Statutit dhe rregullores së UET, si edhe bazuar mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut lëshon diplomën me karakter profesional "Menaxhim". Sipas Statutit të UET, Departamenti është njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimit, duke realizuar të gjitha detyrat dhe mbajtur përgjegjësitë bazuar mbi Ligjin e Arsimit të Lartë. <i>Sipas oragnizimit dhe funksionimit të dekanatit dhe departamentit paraqiten të gjitha kushtet e organizimit dhe strukturës që lidh departamentin dhe fakultetin, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe organeve të tyre drejtuese, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore. Departamenti i Menaxhimit dhe marketingut organizohet në grupe mësimore, ku janë përcaktuar përgjegjësit e grupeve mësimore. Ai është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe organizohet si pjesë e tij. Funksionet e departamentit përcaktohen në tri sfera, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe veprimtaritë administrative.</i> Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është i përbërë nga tre departamente konkretisht: 1. Dep i Ekonomisë dhe Financës, i cili ka; 18 PAE, nga ku 11 grada/tituj; 2. Dep i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili ka 9PAE ,nga ku 8 grada/tituj; 3. Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila ka 8 PAE, nga ku 4 grada/tituj; Për nga numri dhe kualifikimet e stafit akademik, ndërtimi i strukturave dhe zbatueshmëria e ligjit dhe akteve nënligjore, programi profesional në Menaxhim përmbush plotësisht detyrimet ligjore. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i> <i>Evidenca 23. Te dhena tabelore per personelin akademik ne njesine kryesore dhe njesine pergjegjese - Tabela 1 dhe Tabela 2.pdf</i>
Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Sipas Rregullores së Programit të studimit janë përcaktuar objektivat për formimin e studenteve. Në qendër të programit të studimit është studenti, në aspektin e mësimdhënies/mësimnxënies si edhe në daljen e tij në tregun e punës në një drejtim të ngushtë sipas profilit të zgjedhur të menaxhimit. Kompetencat profesionale të studentit në dalje lidhen me profilin e përzgjedhur. Në përfundim të programit studentët kanë mundësinë të zhvillojnë aftësitë praktike përmes një praktike në biznes dhe integrim në tregun e punës. Rezulton se nga ana e UET është realizuar analiza e nevojave të tregut për zhvillimin e këtij programi përmes bordeve të tregut të punës dhe ish studentëve në



	karrierë –Alumni. Gjithashtu vizita në institucion, specifikisht intervistat me pedagogët treguan dhe identifikuan metodat e përdorura prej tyre gjatë procesit të mësimdhënies, ku përdorimi i ndërveprimit, komunikimit dhe dialogut, ndikon në formimin e të kuptuarit dhe të menduarit kritik mbi njohuritë e marra. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i> <i>Tabela 10: Plan mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënës, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, konkretisht referuar dokumentit: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim" si dhe Rregullores së mësimin të programit, GVJ konstatoi se, programi i studimit Diplomë profesionale në "Menaxhim", përmban dhe ofron informacionet e nevojshme lidhur me objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënës, organizimin, strukturën, përmbajtjen si dhe fushat e punësimit. Referuar RVB-së, lidhur me punësimin konkret të studentëve të diplomuar në këtë program, institucioni nuk disponon të dhëna. <i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 39: Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës. pdf</i> <i>Aneksi 1: Rregullore e mësimin të programit. pdf</i>
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	GVJ konstaton se, në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", ndarja e lëndëve është bërë sipas veprimtarive formuese. Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda. Nga shqyrtimi i tabelës 9, rezulton se lëndët kanë 4, 5 dhe 6 kredite, ndërsa praktika profesionale dhe provimi i formimit apo projekti profesional që përmbyll studimet kanë nga 5 kredite. Programi zhvillohet në 4 semestra. Kohëzgjatja e programit është 2 vjet me nga 60 kredite në vit dhe 120 kredite në total. Bazuar mbi dokumentacionin për hapjen e programit të studimit, dokumentat e programit mësimor dhe të planit mësimor, ka një shpërndarje sipas ligjit të moduleve dhe krediteve. Gjithashtu GVJ konstaton se programi Diplomë Profesionale në "Menaxhim", përmban informacion të plotë, për ndarjen e çdo lënde, parashikuar sipas standardeve, në komponentët leksion dhe seminar, orët në auditor dhe jashtë auditorit, orë për praktikën dhe përgatitjen e provimit të formimit si dhe kreditet për çdo aktivitet. Konkretisht si më poshtë: • Lëndë bazë 19 kredite; • Lëndë karakterizuese 58 kredite; • Lëndë të formimit profesional 24 kredite; • Lëndë plotësuese 14 kredite • Lëndë përmbyllëse 5 kredite GVJ konstaton se programi Diplomë Profesionale në "Menaxhim",



	përmban informacion të plotë për ndarjen e çdo lënde në komponentët leksion/seminar, orët në auditor/jashtë auditorit, dhe kreditet për çdo aktivitet. <i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim". pdf</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i>
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Referuar <i>Rregullores së Institucionit (UET), Dokumentit A.III</i>, si dhe nga biseda me stafin akademik përgjegjës për këtë program studimi, rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara ngarkesa mësimore dhe orët në auditor si dhe klauzolat për, skemën e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët e programit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithë semestral dhe vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë: • Niveli i diskutimit në seminare 10 % • Provimi i ndërmjetëm 30 % • Detyrë kursi 20% • Provimi përfundimtar 40 % Në total studenti mund të përfitojë 100 pikë të mundshme. Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur si detyrim prezencën në masën 60% në veprimtaritë mësimore në auditor (leksionet dhe seminare) GVJ është e mendimit se këto skema vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit. <i>Evidenca 5: Rregullore e UET. pdf</i> <i>Evidenca 39: Dokumenti A.III., Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (A.III.5). pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. Pdf</i> <i>Evidenca 19.1: Formati i Syllabusit Cikli I dhe i II. pdf</i>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktiviteteve formuese të programit të studimit.	Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit të mësimin, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. Pdf</i> <i>Evidenca 19.1: Formati i Syllabusit Cikli I dhe i II. pdf</i>
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshëm i fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", rezulton se programi i studimit është në vitin e dytë dhe është diplomuar tashmë gjenerata e parë e studentëve në këtë program. Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" për nga mënyra se si është konceptuar, nëpërmjet lëndëve që përmban,

	syllabuseve të tyre dhe mënyrës së organizimit të lëndëve, synon të jetë fleksibël i orientuar drejt zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e menaxhimit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. <i>Megjithatë, për vetë karakterin që ka ky program, përgatitjen e profesionistëve në aspekte të ndryshme të fushës së menaxhimit, për ti shërbyer në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe për të qenë më shumë i orientuar drejt aftësive dhe kompetencave profesionale, që nevojiten në këtë fushë, GVJ, sugjeron, që në të ardhmen në planin mësimor të këtij programi, theksi të vihet më shumë tek lëndët e formimit profesional si dhe tek praktika profesionale.</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i>			
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", është një program studimi që përgatit profesionistë në fushën e menaxhimit. Plani mësimor i këtij programi ka në përbërje të tij, lëndë që i ofrojnë studentit njohuri teorike dhe aplikative në fushën e menaxhimit, duke i shërbyer përgatitjes së profesionistëve dhe menaxherëve në disa drejtime të fushës së menaxhimit. Referuar planit mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", syllabuseve të lëndëve si dhe takimit që, GVJ pati me drejtues të njësive kryesore, asaj bazë përgjegjëse për këtë program studimi si dhe me stafin akademik, rezultoi se në këtë program, mësimi praktik ka peshën e duhur duke krijuar mundësinë që studentët të marrin elementet konkrete të punës. Pavarësisht kësaj, GVJ është e mendimit që plani mësimor i programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", në vazhdimsi duhet të nënshtrohet rishikimit të tij, duke i dhënë më shumë peshë mësimi praktik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Referuar programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", GVJ konstaton se programi është strukturuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përmban: • 120 Kredite të ndara në 2 vite akademike me 60 kredite secili; • Orë totale 3000, ku, 1195 orë në auditor dhe 1805 orë jashtë auditorit; • Për çdo lëndë të përfshirë në programin mësimor është përcaktuar ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë auditorit; • Çdo vit akademik përbëhet nga dy semestra me 15 javë

	mësim; • Në vitin e parë zhvillohen 1475 orë, ku, 563 orë në auditor dhe 912 orë jashtë auditorit; • Në vitin e dytë zhvillohen 1525 orë, ku, 632 orë në auditor dhe 893 orë jashtë auditorit; GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>Evidencat 14.3 dhe 14.4: Formula për Regjistrimin e Lëndëve Semestri I dhe Semestri II. pdf</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i>
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënës dhe punësimit të studentëve.	GVJ është e mendimit se programi studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", ka përputhshmëri, midis emërimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat do të mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënës dhe punësimit të studentëve, nëpërmjet marrjes së njohurive teorike dhe aftësimit praktik të tyre. <i>Megjithatë GVJ, mendon që programi në një rishikim të mëtejshëm të tij, mund të pasurohet me lëndë të karakterit praktik që lidhin me shërbime specifike të fushës së menaxhimit.</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Sipas RVB-së, në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore bën të mundur arritjen e objektivave kryesore formuese të programit. Përsa i përket ngarkesës në kredite dhe raportit leksion/seminar konkretisht në këtë program kemi: • 420 orë leksione • 426 orë seminare • 125 orë praktika profesionale në terren Pra raporti teori praktike: 420/551, ose 0.7 me 1. <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundërt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion.	Referuar dokumentave raporti leksion/seminar mundëson përfundimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre në praktikë nga studentët. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve si dhe takimi me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra, raste studimore. Lëndët karakterizuese dhe ato të formimit profesional, respektivisht në kategoritë B dhe C si: Parimet e Kontabilitetit, Parimet e Shpërndarjes dhe të shitjes etj., u krijojnë mundësi studentëve të punësohen në specialitete të tilla si: Specialist investimesh, Specialist

	shitjes, etj. GVJ konstaton se nuk përmbushet 25% e programit në aftësim praktik dhe rekomandon të shtohen lëndët e praktikës në planin mësimor. Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf Evidenca 7: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit. pdf			
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ është e mendimit që përmbajtja e programi të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", garanton përfundimin e dijeve, aftësive praktike dhe kompetencave në fushën e menaxhimit. Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe nga takimi me stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit, GVJ konstaton se Institucioni ka një bashkëpunim të ngushtë me disa biznese gjë që mundëson përshtatjen sa më të mire të programit të studimit me tregun e punës. Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf Evidenca 7: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit. pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", ofruar nga Departamentit Menaxhimit, të Fakultetit të Biznesit dhe Zhvillimit pranë UET, referuar dokumentacionit, rezulton të jetë i organizuar, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët në program janë karakterizuar sipas veprimtarive formuese dhe kanë të përcaktuar ngarkesën dhe numrin e krediteve. Nga evidencat rezulton se së bashku me praktikën profesionale, programi përmban 21 lëndë, si dhe provimin e formimit ose një projekt profesional në përfundim të studimeve. Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" realizohet në 2 vite, ndarë në 4 semestra, gjatë të cilit studenti fiton 120 kredite dhe realizon: • 1195 orë në auditor; • 1805 orë punë individuale • 125 orë praktika profesionale; • 125 orë provim formimi

	<i>Evidenca 14.1: Kërkesë për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit-Program me karakter Profesional në "Menaxhim". Pdf</i> <i>Evidencat 14.3 dhe 14.4: Fomula për Regjistrimin e Lëndëve Semestri I dhe Semestri II. pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", është një program i ri që synon arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e tmenaxhimit në përputhje me kërkesat e tregut për profesionistë në sektorë të ndryshëm të biznesit. GVJ, në lidhje me planin mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", gjykon se plan mësimor ka në përbërje të tij, lëndë që i ofrojnë studentit njohuri teorike dhe aplikative, duke i shërbyer përgatitjes së profesionistëve në përshtatje me tregun e punës. GVJ konkludon se nëpërmjet realizimit të misionit të tij, programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", synon formimin e shprehive dhe aftësive në disa drejtime menaxheriale.. Referuar përmbajtjes së programit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", syllabuseve të lëndëve dhe takimit që GVJ pati me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për këtë program studimi, rezultojnë se ky program studimi, krijon mundësinë që studentët të marrin njohuri dhe aftësi praktike në fushën e menaxhimit në sektorë të ndryshëm të biznesit.
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjes e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	GVJ, bazuar në planin mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe takimeve me studentë të programit si dhe me stafin akademik të përfshirë në program, është i mendimit se programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", nëpërmjet lëndëve që përmban, syllabuseve të tyre, si dhe mënyrës si organizohen lëndët, synon të jetë i orientuar drejt zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e menaxhimit.
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Referuar evidencave si dhe takimit me drejtuesin e njësive kryesore dhe asaj bazë, rezultojnë se elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve konkrete, komunikimin, si dhe orientimin në përvojën e punës. Program i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", rezultojnë se të ketë 20 lëndë, praktikën mësimore dhe provimin e formimit, ku lëndët zhvillohen në 4 semestra me 120 kredite dhe provimin e formimit dhe praktika profesionale kanë secila nga 5 kredite. Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. GVJ konstaton ndarjen e veprimtarive formuese në planin mësimor si më poshtë: • Lëndë bazë (kategoria A), me 19 kredite, që kanë 15.8% të krediteve; • Lëndë karakterizuese (kategoria B), me 58 kredite, që kanë

	48.3% të krediteve; • Lëndë të formimit profesional (kategoria C) me, 24 kredite, që kanë 20% të krediteve; • Lëndë plotësuese (kategoria D) me, 14 kredite, që kanë 11.7% të krediteve • Lënda përmbyllëse (kategoria E) me 5 kredite, që ka 4.2% të krediteve; GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbytje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion/seminar.			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	GVJ, duke u konsultuar me dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni si dhe gjatë vizitës në institucion siguroi informacion për institucionet me të cilat UET ka bashkëpunim dhe marrëveshje, për organizimin e programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim si dhe për realizimin e praktikave profesionale në kuadër të këtij programi. <i>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të Punës. pdf</i> <i>Evidencat 12.3 Panairi i Punës, 2019, 2019. pdf</i> <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i> <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me SBC kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. UET angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Gjithashtu përmes sistemit LMS, UET ka mundësi të aplikojë format e të mësuarit e-learning, përmes ofrimit të materialeve në sistem elektronik si video, teste, forume, animacione të cilat ndihmojnë personelin të krijojë metoda më novatore dhe të standartizuara të mësimdhënies. Kjo e fundit u vlerësua dhe gjatë periudhës së pandemisë Covid 19. Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga SBC në bashkëpunim me struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimit gjatë mësimdhënies të përbërë nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe përgjegjësat e grup-lëndëve. Procesi realizohet duke përdorur disa procedura dhe instrumenta si: - Monitorimi i provimeve në sezonin e provimeve përfundimtare, ku kontrollohet mënyra e vlerësimit dhe procedura e rivlerësimit të studentëve. Rezultatet pasqyrohen në raportet përkatëse; - Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët përmes fokus grupeve dhe anketimit semestral të tyre. Pas zbardhjes së intervistave të fokus grupeve hartohet raporti i cili u vendoset në dispozicion departamenteve përkatëse; - Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga ekspertë të jashtëm në drejtimin e rektorit; - Dokumentim i performances akademike nga stafi akademik, i cili në mënyrë periodike pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve; UET bën vlerësime periodike të mësimdhënies nga studentët përmes metodave të fokus grupeve dhe anketimeve. Anketimi hartohet nga KSBC dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të. Ky proces ndodh dy herë në vit, në përfundim të semestrit dhe përpara sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet e anketimit janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me intervistat e zbardhura të fokus grupeve periodike. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter</i>

	profesional "Menaxhim" Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET Evidenca 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf
Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	Në programin me karakter Profesional "Menaxhim" format kryesore të mësimdhënies janë: Leksionet (2 orë në javë për çdo lëndë); Seminare (1 orë në javë për çdo lëndë); Projekte/Detyra, (pjesë e vlerësimit të lëndës); Praktikë profesionale; Metodat e transferimit të njohurive tek studentët janë bashkëkohore dhe përfshijnë mjete audio-vizive dhe sistemin online LMS që ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga takimi me studentët u evidentuan lehtësirat e sistemit LMS në rritjen e interaktivitetit me pedagogun dhe jashtë auditorit veçanërisht në kushtet e Covid 19. Pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimi, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimi të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për tu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit. GVJ rekomandon të rishikohet raporti mes teorisë dhe praktikës në programin e studimit, duke e përshtatur sipas karakterit profesional të tij, mundësisht në 1 orë leksion dhe 2 orë seminar për çdo lëndë. Në këtë mënyrë do të thellohej mjeshtëria praktike e programit dhe do të diferenciohej nga i njëjti program studimi bachelor, si lidhur me ngarkesën dhe me përmbajtjen. Përprjekja e pedagogëve për thjeshtimin e lëndëve të programit dy vjeçar nuk mjafton, ajo duhet të reflektohet në programin e studimit me rritjen e ngarkesës praktike dhe trajtimin të teknikave të fundit në nivel arsimit profesional në funksion të nxitje së aftësive teknike të studentëve. Kjo e fundit e reflektuar dhe në formimin e praktikës mësimore e cila duhet të ketë një peshë më të lartë se 5 kredite (rekomandohet të paktën 12 kredite) duke plotësuar kërkesat e programit. Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit	Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve Programi me karakter Profesional "Menaxhim" përfshin format e mësimi teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i

dhe nevojave të studentëve.	modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit. Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik. Për shkak të karakterit praktik të moduleve, përdorimi i rasteve reale të bizneseve për studim e bën më tërheqëse dhe aplikativ programin për studentët. Siç u theksua prej tyre, pedagogët janë të gatshëm të përgjigjen dhe asistojnë studentët për çdo paqartësi. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive-DP në "Menaxhim". pdf</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i përfshirë në programin me karakter praktik "Menaxhim" përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Stafit akademik mban gradën profesor dhe doktor në përputhje me ciklin e studimit ku japin mësim. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. UET ka hartuar kurrikulat mësimore në përshatje me kërkesat e tregut, por GVJ sugjeron të rishikohet përmbajtja e lëndëve e duke vlerësuar se në ciklin profesional të studimeve njohuritë dhe aftësitë e studentëve duhet të avancohen në drejtim të profilit teknik të zgjedhur. Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në ASCAL rezulton se plani mësimor mbulohet nga pedagogë të brendshëm në masën 90%. Stafit akademik është i angazhuar në këshillim për studentët dhe ndihmon e asiston në detyra administrative. <i>GVJ gjykon të rritet angazhimi i stafit akademik me profil profesional për aftësimin e studentëve në këtë drejtim dhe përmbushur objektivat e nivelit dhe programit të studimit. Si dhe rritjen e angazhimit të profesionistëve me eksperimente në fushën specifike të lëndës.</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 20. CV e Stafit Akademik për Programet e Studimit.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik	UET trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores së UET, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me

për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Përkatesisht nga takimi me studentët u pohua se studentët kanë patur mundësinë të diskutonin me menaxherë të bizneseve të fluar si metodë e re pedagogjike, në përputhje me objektivat formuese të lëndëve dhe rritjen e kopetencave sipas kërkesave të punëdhënësve. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, UET ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorët kompjuterike ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e UET. pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Procesi mësimor i programit me karakter praktik në Menaxhim zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m² dhe Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m². Të dy godinat janë të ndara në: salla leksionesh, ku të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme. Gjithashtu studentët kanë në dispozicion bilbotekën 300m², laboratorë mësimorë informatike, si laborator 205 B me 25 PC dhe video projektor, ai 206 B me 35 PC dhe video projektor, 207 B me 35 PC dhe video projektor, 208 B me 80 PC. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal EfiFi, i cili ndihmon në procesin mësimor. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor. Stafi i IT-së ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi. Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë,
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	

	konstatuam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillim e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise vëzhguam salla leksione e seminare, laboratorë, salla mbledhjesh, zyra e studio të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi. Të gjitha janë të pajisura me mjetet mësimore si kompjuter e video-projektor të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, date 10.05.2017, është 2.5 m² për student. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e praktikës mësimore. GVJ u njoh me laboratorët e UET, në vecanti me Laboratorin e Novacionit, ku është instaluar dhe printer 3D. UET ka vendosur në dispozicion të studentëve katër laboratorë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar të gjitha programet (softëare) për realizimin e punës së pavarur nga studenti. Këto laboratorë janë pajisur dhe përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë universiteti. Bibloteka gjithashtu është e pajisur me 8 kompjutera dhe me 150 vende leximi dhe disponon mbi 6000 tituj librash. Studentët kanë akses në bibliotekën elektronike, ku studentet dhe stafi mund të shkarkojnë artikuj shkencor, përkatësisht ne Ebsco, Sage abonim 5 vjeçar. Bibloteka ka një staf të gatshëm në ndihmë të studentëve. Procesi mësimor mbështetet nga sistemi LMS (Learning Management System), i cili bën të mundur që studenti të informohet nga pedagogu kudo që ndodhet dhe të ndërveprojë me kolegët e kursit online. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se UET ka infrastrukture të konsoliduar për realizimin e programit mësimor. <i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf</i>
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në modulet e këtij program studimi ofrohet në gjuhën angleze. Baza mësimore që u ofrohet studentëve përfshin tekste mësimore, cikle leksione, leksione në ppt, materiale plotësuese. Duke pasur në vëmendje që programi ofrohet në gjuhën shqipe, <i>GVJ sugjeron të pasurohet fondi i bibliotekës me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. Të përzgjidhet me kujdes literatura bashkëkohore dhe të bëhet një përkthim profesional i titujve kryesorë në gjuhën shqipe.</i>
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online në të cilat UET është abonuar si virtuale si: Sage, Ebsco, Emerald, Cambridge University, Questia nga kudo ku ata ndodhen. Nga vizita në institucion rezultoi se bibloteka virtuale nuk përdoret në mënyrë të konsiderueshme nga studentët.
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET ka në dispozicion të studentëve 4 laboratorë mësimorë informatike të pajisur me programe risi në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu ka dhe laboratorin e novacionit ku studentët mund të kryejnë në praktikë lëndët si Animacion 3D dhe Menaxhimi i Inovacionit. UET ka siguruar infrastrukturen e nevojshme për

	studentët, por nga vizita rezultoi se ajo nuk shfrytëzohej mjaftueshëm prej tyre, kjo e lidhur dhe me kufizimet e pandemisë covid 19.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UET ka në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të materialeve mësimore nga pedagogët për studentët. LMS është i aksesueshëm online për të gjithë pedagogët dhe studentët. Në kushtet e pandemisë dhe zhvillimit të mësimdhënies online UET adoptoi platformën Microsoft TEAMS të cilën nga takimet me stafin dhe studentët rezultoi se përdorej me lehtësi dhe garantonte menaxhimin e procesit mësimor, për shkëmbimin e njohurive dhe materialeve të nevojshme për programin e studimit. GVJ konstatoi se UET ka një sistem informatik bashkëkohor dhe cilësor në aspektin e kërkimit dhe të zhvillimit të procesit mësimor <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun. Pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UET ka organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë: - Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë; Veprimtaria e KSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në: -Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances; -Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; -Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; -Ndjekja e vazhdueshme e ecures së kërkimit shkencor në institucion.

	Këto njësi ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit. <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i>Aviola Bardhi/01.06.2021 14:30 <i>Evidenca 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i>Aviola Bardhi/01.06.2021 14:30 <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si dhe Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit, të performances akademike- mësimore, këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me KSBC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të ftuar vendas të cilët janë personalitete në fushën e tyre, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë dhe nga programi ERASMUS+. Të gjitha këto shkëmbime i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ofron trajnime ndërkombëtare në kuadër të programit Erasmus+ për stafin akademik dhe personelin ndihmes akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet praktikës së leksioneve të hapura. Veçanërisht për programin e studimit me karakter praktik në Menaxhim, GVJ në takimet me drejtuesin e Departamentit, stafin akademik, NJSBC, u njoh me faktin që konceptimi i procesit mësimor është bërë duke synuar vënien e studentit në qender. Kjo ka sjelle ndryshim nga metoda tradicionale, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime dhe pyetje studentit. Zhvillimi i orëve interaktive, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit, nxitja e debateve, mendimit kritik, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punimeve janë disa prej mjeteve kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.

	Metodat e reja të mësimdhënies, nëpërmjet seminareve të dedikuara, leksioneve të hapura workshope etj, janë bërë të njohur në të gjithë trupen akademike të UET, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në vijimësi. Përfshirja e studenteve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është periodike për të gjitha aspektet akademike dhe administrative të UET.								
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	UET angazhohet në të nxënit teorik dhe praktik përmes metodave ndërvepruese. Pedagogët në Programin 2 vjeçar Menaxhim inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime brenda në klasë, punime individuale dhe në grupe. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë konceptet dhe stimulon aplikimin e tyre praktik. Gjithashtu Departamenti i Menaxhimit e Marketingut në bashkëpunim me KSBC ka aplikuar metoda të ndryshme për kontrollin e shkallës së përvetësimit të lëndëve nga studentët. Në kuadër të rritjes së performancës mësimore dhe zhvillimit të metodave inovative kanë ndihmuar dhe specializimet e pedagogëve në Universitete Perëndimore, pjesë e shkëmbimeve Erasmus+.								
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Institucioni ka realizuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura me personalitete dhe lektorë të huaj, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Metodat e reja janë diskutuar nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit dhe aplikuar tek studentët. KSBC analizojnë efektet e pritshmëritë të studentëve dhe i raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet Përgjegjësit të Departamentit, i cili rishikon metodat e mësimdhënies me stafin akademik. <i>GVJ inkurajon më tepër mbështetje me veprimtari praktike të procesit mësimor të programit profesional në menaxhim me qëllim forcimin e mjeshtrërive teknike e aplikative në përafrim të kërkesave të tregut të punës.</i> <i>Evidencat 12.3 Panairi i Punës, 2019, 2019. pdf</i> <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të	Bazuar në rregulloren e UET, format e kontrollit të dijeve përcaktohen në nenin 24 si më poshtë: Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin



posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtime të vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm: 24.1 Për lëndët e Tipologjisë I a. Provimit përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%) 24.2 Për lëndët e Tipologjisë II a. Provimit përfundimtar (40%) b. Provimit të ndërmjetëm (30%) c. Detyrës së kursit (20%) d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%). Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në sistemin LMS nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. <i>Evidenca 5: Rregulloret e UET. pdf</i> <i>Evidenca 39: Dokumenti A.III., Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (A.III.5). pdf</i>
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: pjesëmarrja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; Provimi përfundimtar. Vlerësimi i studentit ndahet në vlerësim i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Duke shqyrtuar Syllabuset e lëndëve rezultoi se raporti është në masën 70% (provimi përfundimtar) dhe 30% vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (aktivizimi, detyra kursi, testime). Kjo formë inkurajon angazhimin të studentëve gjatë kursit. <i>Megjithatë, duke vlerësuar karakterin profesional të programit 2 vjeçar të studimit në "Menaxhim", GVJ gjykon se raporti i vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar duhet të jetë në funksion të zhvillimit të aftësive teknike të studentëve në raport me ato teorike.</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Syllabuset e çdo lëndë përmbajnë kontrollet që do të kryhen gjatë zhvillimit të saj. Vlerësimi i kontrolleve bëhet me pikë që i bashkohen vlerësimit përfundimtar. Në vlerësimin përfundimtar kontribuojnë edhe frekuentimi, detyrat e kursit, aktivizimi gjatë zhvillimit të ushtrimeve dhe mësimave praktike. Pedagogu informon studentet për rezultatet e çdo kontrolli. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe	



vlerësimit, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Studentët e programit të studimit mund të informohen edhe në distance përmes sistemit LMS në lidhje me lëndët, përmbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive. UET i kushton shumë rëndësi transparencës dhe privatësisë së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik LMS, lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit. UET ka filluar të përdorë format e vlerësimit në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score), një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve. Kjo redukton abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve. Në kushtet e pandemisë Covid 19, studentët kanë përdorur sistemin elektronik për testimin e njohurive Microsoft TEAMS, i cili garanton anonimin në përputhje me rregulloren në fuqi. <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i> <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guide për pedagogun. Pdf</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët e programit 2 vjeçar në Menaxhim zhvillojnë projekte, detyra kursi dhe raste studimore në çdo lëndë. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe çfare duhet të përmirësojnë. Ky process ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies dhe të ballafaqimit me audiencën. Gjithashtu, nga vizita në institucion dhe RVB u konstatua se vlerësimi i dijeve në provim shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Paskësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Përmes sistemit online MOODLE UET LMS, studenti informohet brenda afateve të përcaktuara nga institucioni për rezultatet e provimit. Sipas rregullores së UET, dorëzohen tezat e korigjuara brenda një jave nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit. Stafi akademik dorëzon rezultatet e vlerësimit të seminareve dhe detyrave të kursit, gjatë javës së 14-të të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet para datës së zhvillimit të provimit përfundimtar. Sipas pikes 5.7 të rregullores, studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë,

	i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun. Pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", operon që prej vitit 2018, i miratuar me Urdhër Nr. 554, datë 11.09.2018 nga Ministria e Arsimit. Programi i Studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" përbën një risi jo vetëm për Universitetin Europian të Tiranës që e ofron, por për të gjithë tregun e arsimit të lartë shqiptar, si publik ashtu edhe privat, duke përgatitur profesionistë në fushën e Menaxhimit për të kontribuar në rritjen e performacës së biznesit.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe me 120 kredite ECTS, me një kohëzgjatje studimi 2 vjet. Gjatë shqyrtimit të programit të studimit, takimeve me stafin akademik dhe përgjegjësin e departamentit, <i>GVJ konfirmon se përmbajtja e programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" nuk garanton përfitim maksimal të aftësive dhe kompetencave praktike dhe profesionale. GVJ rekomandon që ky program të ketë prioritet të veçantë zhvillimin e praktikës profesionale në subjektet, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit dhe ti jepë mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale në integrimin e praktikës në çdo lëndë. Njohuritë që ofrohen nëpërmjet këtij programi dhe kompetencat që përftojnë studentët pritet që tu mundësojnë atyre punësimin në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës, ndaj është domosdoshmëri rishikimi i ngarkesës teorike e praktike në këtë program.</i>
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	<i>Sa më sipër, GVJ rithekson që mësimdhënia të realizohet mbi bazë kompetencash e t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Duke patur</i>



	<i>parasysh natyrën e programit, praktika në terren zë një vend shumë të rëndësishëm si formë e mësimdhënies.</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i>			
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde në seksionin "Përmbledhje dhe qëllimet e kursit". Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave e rezultateve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme lidhur me qëllimet e programit të studimit. Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar. UET tregon vemendje të veçantë lidhur me interaktivitetin dhe bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik e i përhershëm që zhvillohet në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit apo të kërkojnë këshillime për çdo ide të tyre për inovacion apo zhvillim të zgjidhjes së problemit. <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset Akademike 2020-2021. pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	UET ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Në rasti në provimit të diplomës, udhëzimet dhe materialet e nevojshme, përfshi bankën e pyetjeve i vendosen në dispozicion studentit nga Departamenti. <i>GVJ thekson domosdoshmërinë e konkretizimit të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit. Mbi të gjitha lëndët e profileve duhet të konkretizojnë njohuritë e specializuara të profilin me raste praktike.</i> <i>Gjithashtu, kjo do të shërbente studentëve si faze reflektimi mbi kompetencat e fituara dhe qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve praktike.</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor DP në "Menaxhim". pdf</i>			
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Referuar RVB-së, dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore në UET, rezultojnë se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik sipas Rregullores së Burimeve Njerëzore në UET. Ka një koordinim mes njësisë bazë përgjegjëse për këtë program si dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore në nivel institucioni, me përgjegjësi të ndara dhe në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore. Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë takimit, GVJ konstaton se UET, harton kërkesa të përgjithshme, kriteret bazë si dhe kriteret preferenciale për stafin e programit. Institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik. Bazuar në procedurën e konsultuar gjatë takimit si dhe asaj që është pjesë e dosjes së vetëvlerësimit, për staf akademik, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit si dhe vlerësimi mbështeten në kriteret e publikuara dhe në metodologjinë e vlerësimit të publikuar në thirrjen për punësim. <i>Evidenca 11: Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore. pdf</i> <i>Evidencat 11.1: Shembull thirrje për staf akademik. pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.	GVJ, gjatë takimeve si dhe nga konsultimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, konstatoi se Zyra e Burimeve Njerëzore ruan dhe përditëson të dhëna të plota për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme, personelin ndihmës mësor dhe shkencor si dhe atë administrative, të angazhuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim". Këto të dhëna, të sistemuara në dosje, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale. <i>Evidenca 11: Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore. pdf</i> <i>Evidenca 44.1: Format Dosje Staf Akademik me kohë të plotë. pdf</i> <i>Evidenca 44.2: Format Dosje Staf Akademik me kohë të pjesëshme. pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për	Referuar strukturës organizative të institucionit, stafit akademik dhe joakademik të përfshirë në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe asaj kryesore, rezultojnë se UET ka vënë në dispozicion të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" personel të angazhuar dhe optimizim përdorimin e burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të këtij programi.

kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se i gjithë personeli akademik efektiv (PAE) (100%) është i angazhuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim”. Kjo shpërndarje siguron një angazhim dhe përfshirje të lartë të stafit efektiv të programit, duke i shërbyer realizimit të objektivave të programit të studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim”. Nga RVB si dhe nga diskutimet me stafin akademik të programit, rezulton se UET ofron mjedise dhe zyra me kushte të pranueshme për stafin akademik dhe atë jo akademik. <i>Evidenca 30.8: G4-1 : Formular i vlerësimit të pedagogut nga kolegëtpdf</i> <i>Evidenca 40: G4-2: Formular i vlerësimit të pedagogut nga studentër. pdf</i> <i>Evidenca 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit. pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	GVJ, konstaton se institucioni, ka si prioritet zhvillimin e profesional dhe akademik të stafit. Referuar GVB-së si dhe informacioneve në takimet me stafin e programit si dhe drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni mbështet stafin akademik duke suportuar shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe trajnime Brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, bazuar në përgjegjësitë që ka për cilësinë e personelit të angazhuar në program, institucioni ndjek politika nxitëse dhe motivuese për bashkëpunim me institucionet homologe të vendit, rajonit dhe më gjerë. UET, ka mundur për personelin trajnime dhe workshope, të tilla si “Trajnimi për platformën Teams” dhe “Trajnimi UET LMS”, me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të tij, sidomos në kushte të zhvillimit të mësimi Online, për shkak të pandemisë. <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun. pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar evidencave të siguruar për kapacitet infrastrukturale të UET, si dhe takimeve në institucion, GVJ, është i mendimit se, në dispozicion të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", UET siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore, për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me numrin e studentëve, natyrën dhe modulet përkatëse të tij. <i>Evidenca 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit. pdf</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje	GVJ, gjatë vizitës në institucion si dhe referuar RVB-së, konstatoi se në dispozicion të studentëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" ka salla leksionesh, seminaresh, laboratorë informatike,

elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	salla për praktikë lëndore/profesionale bibliotekë etj. Referuar RVB-së dhe komunikimit me studentët, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim", disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sallat mësimore janë të pajisura me poste ulje, tavolina, pod lekturimi, kompjutera, videoprojektorë si dhe pajisje të tjera të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, në të gjitha mjediset funksionon sistemi i kondicionimit <i>Evidenca 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit. pdf</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	GVJ, nga vizita në institucion konstatohet se laboratorët janë të përshtatshëm për realizimin e orëve të mësimin në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim". Laboratorët janë të pajisur me njënumër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Sa u përket pajisjeve dhe infrastrukture, situata është e kenaqshme për realizimin e orëve mësimore lidhur me teknologjinë UET ka inaguaruar gjatë vitit të fundit sallën e re InnoLab, pjesë e projektit Innovation Hub. Kjo hapësirë është e dedikuar jo vetëm për aktivitete të lidhura me lëndë specifike të këtij programi studimi, por mund të shërbejë edhe për aktivitete të tjera për klubet studentore aktive të UET. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC, ambient për të zhvilluar takime/mbledhje, etj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Nga takimi me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" si dhe me studentët, rezultoi se UET, me kapacitetet që zotëron, garanton zhvillimin e praktikës profesionale në auditor e parashikuar për 4 javë në 8 orë gjithsej. Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Edhe pse EUT ka një sërë marrëveshjesh me shumë institucione për zhvillimin e praktikës profesionale, për këtë vit akademik ajo nuk është zhvilluar në institucion për shkak të situatës me pandeminë. <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në	UET ka në dispozicion të studentëve edhe bibliotekën mësimore, ku

dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	mundësitë e shfrytëzimit të bibliotekës janë të barabarta për të gjithë studentët. Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar mirë, lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBIS, ku COBIS.Net, është një rrjet ku përfshihen vendet e rajonit dhe të Europës Jugë lindore, që përfaqëson një model lidhjeje të bibliotekave me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike të përbashkët dhe me baza locale. Programet kompjuterike dhe pajisjet teknike si dhe shërbimi WIFI janë në dispozicion të programeve të studimit për të gjithë studentët pa kufizime. <i>Evidenca 45.1: Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e bibliotekës. pdf</i> <i>Evidenca 45.2: E-IV-2. Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë. pdf</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit. Numri i titujve në gjuhën shqipe dhe të huaja, për programin e studimit është i mjaftueshëm. Referuar RVB-së, nga 6425 tituj që disponon biblioteka në UET, 1392 tituj i shërbejnë Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, përgjegjës për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim". Në dispozicion të studentëve janë 4931 tituj librash dhe 105 tituj revistash dhe periodikë në gjuhën shqipe si dhe 1466 tituj librash dhe 67 tituj revistash dhe periodikë në gjuhë të huaja. Biblioteka punon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira për të punuar. <i>Evidenca 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit. pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga RVB-ja dhe të dhënat e siguruar nga sistemi, rezulton se institucioni ofron akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët për të shfrytëzuar literaturën që është në dispozicion të tyre në përshtatje me kurrikulën e programit, si në hard copy ashtu edhe përmes kompjuterave desktop të vendosur aty. Institucioni bën përpjekje për përditësimin e literatureës. Përditësimi me literaturat më të fundit realizohet përmes abonimit në platformat elektronike, ku ka akses në rrjetin e bibliotekave sipas sistemit COBIS, si edhe akses në bibliotekat online. Nisur nga kjo, GVJ, vlerëson se biblioteka ka përshtatshmëri me veprimtarinë mësimore sipas natyrës së programit të studimit. Biblioteka e UET është e abonuar dhe në librarinë elektronike Sage & Ebsco dhe Questia dhe akses në këto platforma ishte pa pagesë për studentët. Biblioteka UET ka funksionalë 12 PC të vëna në dispozicion të studentëve. Të gjitha PC ishin të pajisur me softwarë-t përkatës. <i>Evidenca 45.2: E-IV.2. Formular për pasurimin e fondit të librave në</i>



	<i>bibliotekë. Pdf</i> <i>Evidenca 13: E.VII. Mbi funksionimin e zyrës së kurrikulave. pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Referuar RVB-së si dhe dokumentacionit në system, rezulton se Zyra e Projekteve dhe e Partneriteteve, në UET, përmes punës së saj ka siguruar bashkëpunime me aktorë të jashtëm në funksion të realizimit të programit mësimor, duke u siguruar studentëve mbështetje për përdorimin e burimeve e logjistikës së institucioneve partnere, dhe mundësi në formimin teorik si dhe aftësimin praktik dhe profesional të tyre. <i>Evidenca 32: C.IV. Parimet e organizimit të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, pjesë e Broshurës së dokumentave, fq. 51. pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Referuar evidencave përkatëse (<i>evidencat 49 dhe 50</i>), lidhur me programin e studimit, që po akreditohej, GVJ, konstaton se institucioni çdo vit harton planin financiar duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat në nivel institucional, duke përcaktuar një raport të drejtë midis të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet me prioritet në vazhdimësi. <i>Evidenca 49: Të dhëna mbi koston për student. pdf</i> <i>Evidenca 50: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme. pdf</i>			
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	Bazuar në përpjekjet e institucionit për të rritur të ardhurat jo vetëm nga studentët dhe tarifat e tyre, por edhe nga shërbimet dhe grantet nga projektet, si burim i rëndësishëm GVJ, gjykon që institucioni ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare nëpërmjet gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. <i>Evidenca 49: Të dhëna mbi koston për student. pdf</i> <i>Evidenca 50: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme. pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në	Nga takimet e realizuara gjatë visitës në institucion si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në sistem, rezulton se UET ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e plotë të studimeve që nga hyrja në dalje edhe për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të vetë institucionit. Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	informimin e studentëve mbi kriteret e pranimit të studentëve në programet dy vjeçare të studimit, strukturën e programit, programet e lëndëve, mënyrën e vlerësimit, të diplomimit etj. <i>Evidenca 32: Broshura e Dokumentave në Zbatim të Statutit dhe Rregullores Bazë të UET. pdf</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET. Neni 27.3 Provimet/Rasti i studentëve me aftësi ndryshe.</i> <i>Evidenca 12: E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i>
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Në fillim të çdo viti akademik institucioni publikon nëpërmjet faqes zyrtare të UET, në facebook si dhe në nftime të tjera ndryshe, mënyrë e aplikimit si dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" për vitin akademik përkatës. Numri i studentëve që do të pranohen përcaktohet në funksion të kapaciteteve infrastrukturore të institucionit si dhe mbi bazën e disa kriterëve specifike të përcaktuara paraprakisht nga dekanati, të cilat ju bëhen të njohura kandidatëve çdo fillim viti akademik. <i>Evidenca 27.1: Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim. pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurave të pranimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.	Kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, e vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UET. Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit. <i>Evidenca 27.1: Politikat, kriteret dhe procesi i pranimit të studentëve. pdf</i> <i>Evidenca 7.1: A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve. pdf</i>
Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Departamenti i Menaxhimit informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullores së programit të studimit. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në websitin e UET, ku studentët mund të marrin informacion të hollësishëm, lidhur me organizimin e plotë të studimeve të programit të studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" si dhe për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këto informacione jepen nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët.
Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të	UET, informon studentët në lidhje me programin e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme, rregulloren e studimeve, procedurat në procesin mësimor etj., nëpërmjet zyrës së sekretarisë dhe koordinatorëve si dhe në mënyrë elektronike në sistemin UET-

përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	LMS, dhe në websit-in e institucionit. Në fillim të çdo semestri studentët pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Zyrën e kujdesit për studentët, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës. <i>Web-faqe Universitetit https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/1DP-Menaxhim.pdf</i>			
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacionet e nevojshme për studentët, në UET, monitorohen dhe menaxhohen nga një system të brendshëm të informacionit të mirëorganizuar. Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes zyrës të kujdesit ndaj studentëve, sekretarisë dhe kordinatorëve përkatës, por edhe online nëpërmjet UET-LMS ku pedagogë e student shkëmbejnë materiale të ndryshme lidhur me lëndën dhe programin e studimit. UET disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit (UET-LMS) dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë. <i>Evidenca 46.1: Në zbatim të platformës UET LMS</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Referuar RVB-së, si dhe evidencave të DVV, GVJ konstaton se UET disponon një sistem të menaxhimit të informacionit, që përbëhet nga dy sisteme paralele UMIS dhe LMS dhe që siguron akses për studentët, stafin akademik mësimor dhe kërkimor si dhe stafin administrative, sekretaritë si dhe zyrën e IT. Sistemi LMS është në shërbim të studentëve me synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të tyre në çdo hallkë të procesit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhon informacionin lidhur me aktivitetin e personelit akademik që lidhet kryesisht me syllabuset, programet, mësimdhënien si dhe me partnerët e angazhuar në realizimin e programit. Në kompjuterat e personelit akademik dhe administrative, gjenden të dhënat e Institucionit, ku secili mund të aksesojë në kohë reale informacione mbi strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativë etj.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit në UET, siguron akses të dedikuar në informacionin për secilin pedagog. Çdo hap i procesit mësimor paraqitet me informacione të ofruar nga UMS, nëpërmjet bazës së të dhënave "Dokumenta UET", ndërsa studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse siç regjistrohen në platformën LMS.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të	

integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët	Përmes platformës aktuale mundësohet edhe Komunikimi interaktiv midis pedagogëve dhe studentëve, që gjithashtu komunikojnë edhe përmes e-mailit zyrtar UET. Sistemi elektronik i informacionit të menaxhimit, rezultojnë një sistem integruar me platforma dhe module që mundësojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik. <i>Evidenca 46: E.V.I.I. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS), Manual i përdoruesit të sistemit UMIS. pdf</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Referuar webit të UET, shohim se ky kriter përmbushet pasi ka një informacion të plotë mbi programet e studimit, stafin akademik të programit, CV-të e stafit dhe aktivitetet që realizon UET. Informacioni është i përkthyer plotësisht dhe i vendosur në dy gjuhë. <i>Evidenca 46: Informacione për stafin dhe CV bio e stafit akademik të programit të studimit. https://uet.edu.al/new/fakultetii-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/. pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UET ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin profesional të studimeve universitare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale e analitike. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UET. Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të UET dhe është lehtësisht i aksesueshëm.
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e studimeve 2-vjeçare me karakter profesional përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Sipas rregulloreve të programit të studimit, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS). <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me</i>




	karakter profesional "Menaxhim" Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët, personalisht ose nëpërmjet qeverise studentore, mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni e kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar. Përpara fillimit të çdo viti akademik, UET udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes websitit të tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë në gjimnaze. Nga vizita në insitucion GVJ u njoh me Planin e aktivitete të informimit të maturantëve nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit përpara fillimit të vitit akademik. Ato zhvillojnë aktivitete informuese për kandidatët ku bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi kontaktet e nevojshme, njohjen me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit. Guida e studentit është material që ka informacionin e nevojshëm që duhet të ketë studenti në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në UET. Këshilli Studentor, nga ku studentët mund të marrin informacion edhe nga strukturat e tyre të zgjedhura si senatorët e klasave, përfaqësuesit e tyre në organet drejtuese të universitetit etj. Studentët trajtohen nga këto organe administrative që nga momenti i pranimi, gjatë zhvillimit të studimeve, si dhe pas diplomimit, duke krijuar kështu rrjetin Alumni. Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të huaj, në përputhje me udhëzimet e MASR-it, ku përcaktohen procedurat e aplikimit të shtetasve të huaj që dëshirojnë të jenë pjesë e UET, si dhe kuotat përkatëse. Aktualisht programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe, por në rast të aplikimeve nga studentë të huaj, lehtësisht UET mund të ofrojë programin dhe në gjuhën angleze, bazuar në kapacitet akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të	Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në rregulloren e UET si dhe atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e pranimeve, zyra

studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	e këshillimit të karrierës dhe sekretaria e institucionit. Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë përgjegjëse së bashku me dekanatin dhe Zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit organizojnë takime informuese dhe të përshtatjes me fakultetin, ku atyre ju shpjegohen në detaje përbërja e UET, struktura e tij, objektivat dhe strategjia, përbërja dhe struktura e Fakultetit dhe departamentit. Gjithashtu bëhet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi. UET përdor platformën mësimore LMS ku studente marrin informacionin e plotë për gjithë zhvillimin e procesit mësimor, mungesat, materialet didaktike, rezultatet e kontrolleve etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre. Informacion i plotë dhe i përditësuar për strukturën institucionale dhe programet e studimit mundësohen nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale. <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i> <i>Evidenca 12: Rregullore Mësimore UET</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Zyrën e kujdesit për studentët, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës. Aktivitetet e punësimit të studentëve përfshijnë Panairë pune - UET open days; Biznese të ftuar në auditor; Aktivitete Alumni, dhe Bordet e Punës. Institucioni përmes dy zyrave përgjegjëse inkurajon studentët të marrin pjesë dhe informon ata mbi zhvillimet në tregun e punës. <i>Nga takimi i organizuar me studentët, GVJ tërheq vëmendjen në forcimin e orientimit të studentëve në sigurimin e praktikës së punës pasi sipas komunikimit me ta praktikën e kanë siguruar individualisht.</i> <i>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të Punës. pdf</i> <i>Evidencat 12.3 Panairi i Punës, 2019, 2019. pdf</i> <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i> <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). Pdf</i>
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, UET zhvillon "Javën e Orientimit", nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjithashtu edhe faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e ardhshme të studimit. <i>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të Punës. pdf</i> <i>Evidencat 12.3 Panairi i Punës, 2019, 2019. pdf</i> <i>Evidenca 12.5: Bashkëpunim me Biznesin-Projekti 500+. Pdf</i> <i>Evidenca 32: Tabela përmbledhëse me Institucionet Bashkëpunuese për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Menaxhim" dhe praktikën profesionale (tabela 5). Pdf</i>



Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konfirmon se informacioni rreth ecures së programit, detyrimeve akademike për të përbushur programin, afateve kohore në funksion të përbushjes së programit, monitorohen nga një mirëmenaxhim i brendshëm. UET disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit (UET-LMS) dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distance. Informacioni në lidhje me procesin mësimor është lehtësisht i disponueshëm përmes sistemit LMS dhe tashmë dhe Microsoft TEAMS.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Në analizën mësimore të departamentit të Menaxhimit e Marketingut gjenden të pasqyruara statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin me karakter profesional në Menaxhim. UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Nëpërmjet Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Sipas dokumentit - <i>Cilesia ne hyrje dhe dalje e studenteve te programit me karakter profesional ne menaxhim 2 vjeçar si dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi sipas profileve përkatëse për tre vitet akademike:</i> Për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 36 studentë Për vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar 93 studentë Për vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 24 studentë Ky program ka një brez të diplomuar për vitin 2019-2020 të përbërë nga 12 studentë. <i>Evidenca 27. Te dhena te plota per regjistrimin ecurinie diplomimin e studenteve sipas viteve akademike Tabela 23 dhe Tabela 21.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit	Të dhënat për studentët e regjistruar, të diplomuar, kalueshmeria në vite gjenden pranë sekretarisë mësimore. Sekretaria mësimore disponon dosjet për çdo student, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e maturës shtetërore, listë notash, kontrata dhe aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i

akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	identifikimit, dy fotografi. Për programin e studimeve Profesionale në Menaxhim nuk rezultojnë studentët të transferuar. <i>Evidenca 27. Të dhëna të plota për regjistrimin ecurinë diplomimin e studentëve sipas viteve akademike Tabela 23 dhe Tabela 21.pdf</i>			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju vunë në dispozicion regjistrin themeltar, regjistri i rezultateve të arritura nga studentët të programit Profesional 2 vjeçar në Menaxhim, të cilët rezultuan të plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore për to. Të dhënat në regjistrat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtjes së të dhënave personale të UET-së. Të dhënat statistikore, për programin e studimit menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe departamenti. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj., bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UET-së. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy dhe përdoren si për analiza të aspekteve specifike ashtu dhe në kuadër të raportit vjetor në nivel fakulteti dhe universiteti. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit UMIS, një program informatik i cili administron dhe përpunon të dhënat e studentëve nga sekretaria, drejtuesit dhe personat e autorizuar në kohë reale. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistemin LMS dhe aksesohet vetëm përmes studentit sipas numrit të matriculimit të tij. Sistemi mban të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student me programin që ndjek.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar takimeve në institucion rezultojnë se departamenti harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi programin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe Shërbimit ndaj Studentit, informojnë lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Këto njësi ofrojnë shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, njoftime punësimi periodike, këshillim i personalizuar i karrierës si dhe ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët kanë mbështetjen e UET për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Nga takimi në institucion u informuam se studentët organizohen në Keshillin Studentor, në Focus Grupe për vlerësimin e procesit mësimor dhe dhënë ide për përmirësime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre si dhe në procesin e anketimit për vlerësimin për lëndët dhe pedagogun. GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatin Akademik dhe në komisione të përhershme si NJBSC dhe në Këshillin e Etikës, sipas përcaktimeve në statutin e UET-së dhe rregulloret e ndryshme nëpërmjet të cilave është garantuar përfaqësimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. <i>Evidenca 2: Statuti i UET</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mësimore e programit të studimit me karakter profesional "Menaxhim"</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UET garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët organizohen në Këshilla Studentore ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me ceshtje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu KSBC organizon cdo muaj focus grupe me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese. Nga takimi me studentët mësuam se ata janë në djeni të këtyre stukturave dhe i mbështesin ato. Këshilli studentor i UET (është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. KS ka rregulloren e tij, ka komunikim institucional me strukturat e tjera në UET për të përcuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit. Studentët e UET-së, shprehin mendimet e tyre për procesin mësimor dhe për aspekte që lidhen konkretisht me studentin, nëpërmjet vlerësimeve semestrale, takimeve informale, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentit etj. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit.pdf</i>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,	Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit në raportin 70:30. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e studentëve gjatë kursit. Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat

përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	e plota të njohjes së lëndëve dhe ka procedurë joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme. Në dokumentat rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit është parashikuar procesi i transferimit të studimeve (njohje të pjesshme ose e plotë e studimeve) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit MP. Kjo për faktin se studentët angazhohen në vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes pyetësorëve. <i>(referuar rregullores së programit dhe detyrimit që kanë studentët të përfshihen në plotësimin e pyetësoreve)</i> GVJ konstaton që, institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit në përputhje dhe me kërkesat e tregut të punës. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit.pdf</i>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët përmes anketimeve dhe focus grupeve të realizuara nga institucioni mund të japin mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve Gjithashtu, nga vizita në institucion u informuam se pas çdo provimi pedagogu vendos seanca sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; Sekretaria mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e karrierës ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikant dhe ofertat e punësimit. UET ka krijuar procedurë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me rregulloren e institucionit.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për	UET ka një sistem online për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. UET-LMS ofron informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për

çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorët. Gjithashtu ka ngritur zyrën e kujdesit ndaj studentëve për asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.			
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e karrierës luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në mënyrë të vazhduar dhe periodike për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Përmes panairove të organizuara, projekteve bashkëpunuese me biznesin, bordin e Alumni, UET shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit dhe profilet në tregun e punës.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka bordin e tij të tregut të punës të cilët sigurojnë informacion dhe ua vënë në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional
"Menaxhim" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar (jo universitar) në Menaxhim është hapur në përgjigje e politikave dhe strategjisë të zhvillimit kombëtar, për t'i ofruar tregut të punës, profesionistë me aftësitë e duhura profesionale.
2. Programi i studimit shton në treg mundësitë për afirmimin e specialistëve të menaxhimit të cilët do të orientohen në treg sipas kërkesave të bizneseve, me orientim operacional.
3. Programi i studimit udhëhiqet dhe realizohet nga kapacitete akademike të specializuara dhe të kualifikuara në fushë, duke i dhënë prioritet mësimdhënies e mësimnxënies me studentin në qendër, në realizim të objektivave strategjike të institucionit.
4. Zhvillimi i procesit mësimor mbështetet me infrastrukture të plotë e të mirëpajisur, ku kontribut të veçantë jep Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë e UET-së, gjë që ndihmon në arritjen e standardeve sa më të larta akademike e praktike në realizimin e programit.
5. Ekzistenca e një rrjeti të gjerë partnerësh e bashkëpunëtorësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ekspertë të fushës së shkencave ekonomike si pjesë e vazhdueshme e aktiviteteve të UET përbejnë ndikon jo vetëm në konkretizimin e njohurive në auditor por edhe në rritjen e shanseve të punësimit.
6. Struktura të mirëpërcaktuar për matjen e performancës së stafit, matjen e cilësisë në shumë aspekte të saj si dhe për komunikimin dhe marrëdhënien me studentët.
7. Ndërtimi i Bordeve të Tregut të Punës përmes rrjetit të Alumni dhe ruajtja e një marrëdhënieje komunikimi për të shkëmbyer informacion mbi nevojat e tregut si mundësi punësimi për studentët si edhe përmirësimin e kurrikulës.
8. Niveli profesional dhe kërkimor shkencor i stafit akademik duke përfshirë si staf me eksperiencë ashtu edhe staf të ri dhe kërkues, mbështetet edhe nga pjesëmarrja në projekte dhe grantet specifike për projekte kërkimore të stafit.

Pika të dobta

1. Mungojnë analiza të thelluara mbi përfitimet konkrete në funksion të realizimit të programit mësimor me karakter praktik në Menaxhim në avantazh nga programet Bachelor të ofruar në këtë fushë.
2. Ngarkesa e ulët e veprimtarisë praktike në raport me teorike nuk garanton specializim të mirëfilltë teknik e profesional të studentëve. Praktika e punës si lëndë plotësuese zë një peshë të ulët për programin me karakter profesional "Menaxhim" çka zbeh përfitimin e aftësive praktike dhe zhvillimin e specialistëve operativ në fushën e

menaxhimit. Praktika si komponent i veprimtarisë mësimore, ndikon drejtpërdrejtë në shkallën e aftësimit të studentëve

3. Mangësi në literaturën mësimore për nivelin e edukimit profesional, kjo për shkak edhe të specifikave të nivelit operativ.
4. Angazhimi i pjesshëm i stafit me profil profesional dhe eksperiencë në fushën specifike për aftësimin e studentëve në këtë drejtim dhe përmbushur objektivat e nivelit dhe programit të studimit.

Rekomandime:

1. Njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin e Menaxhimit në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit.
2. Të rishikohet raporti mes ngarkesës teorike dhe praktike të lëndëve duke vlerësuar si domosdoshmëri rritjen e orëve praktike dhe përshtatjen e kurrikulës sipas karakterit praktik të programit dhe në dy vjet të pajisë me aftësi teknike e operacionale specialistë në fushën e menaxhimit.
3. Konkretizim të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit. Mbi të gjitha lëndët e profileve duhet të konkretizojnë njohuritë e specializuara të profilit me raste praktike.
4. Institucioni, të vijojë me hartimin dhe zhvillimin e literaturës mësimore nga profesionistë të fushës, të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional që ofron ky program studimi.
5. Të orientohen studentët drejt aftësive praktike, mënyrës së kërkimit të punësimit më të mirë që u përshtatet me programin e studimit. Si dhe zhvillimi i kurrikulës së studimit me lëndë operacionale për të përgatitur studentët në hapat drejt tregut të punës e kualifikimeve praktike
6. Përvec stafit të brendshëm të angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, rekomandojmë të vazhdojë angazhimi i stafit të specializuar të jashtëm me përvojë aplikative në fushën e menaxhimit.
7. Gjurmim të qëndrueshëm të alumnit në tregun e punës, çka do të ndihmojë në nxitjen e kërkesës së ardhshme për këtë program.



**Evaluation Conclusions of the professional study program "Management" " of the
Institution of Higher Education "European University of Tirana"**

Strengths and affirmations:

1. The 2-year (non-university) professional study program in Management has been developed in response to national development policies and strategies, to provide the labor market professionals/employees with the appropriate professional skills.
2. The professional study program in Management has an impact in the market adding opportunities for affirming marketing specialists who will be market-oriented according to business requirements.
3. The study program is led and realized by specialized and qualified academic capacities in their fields, giving priority to teaching and learning with the student at the center, in realization of the strategic objectives of the institution. This program is implemented in suitable infrastructural conditions.
4. The teaching process is supported by a complete and well-equipped infrastructure, where a special contribution is given by the Department of Management and Marketing as a basic unit of UET, which contribute to achieving the highest academic and practical standards in the implementation of the program.
5. The existence of an extensive network of partners, national collaborators, experts of the economic sciences as part of a continuum of UET activities, influences not only the concretization of knowledge in the auditorium but also the increase of employment opportunities.
6. Well-defined structures for measuring staff performance, measuring quality in its many aspects as well as for communication and relationships with students.
7. Labor Market Boards are built through the Alumni Network and a strong relationship is maintained to share information on market needs, job opportunities for students, and curriculum improvement.
8. The professional and scientific research level of the academic staff, including research staff is also supported by participation in projects and specific grants for staff research projects.


Weaknesses

1. There is a lack of in-depth analysis on the competitive advantage of the professional curriculum in Management compared to the Bachelor programs offered in this field.
2. The low workload of practical activity in relation to theoretical does not guarantee genuine technical and professional specialization of students. Internship as a supplementary subject has a low weight in this program of professional character which influences the practical and operational competences and skills of future specialists in the field of management. Internship as a component of the learning activity, directly affects the level of training of students.
3. Shortcomings in the academic literature for the level of professional education, due to the specifics of this operational level.

4. Partial engagement of staff with professional expertise and experience in the specific field for the training of students in meeting the objectives of the professional level of study.

Recommendations:

1. The responsible unit of the program shall undertake an in-depth market study regarding the trends and rapid changes in the Management profile in order to reinforce the advantages of this program in relation to other Bachelor programs offered in the field of business.
2. Review the ratio between the theoretical and practical significance of the courses, as a necessity to adapt the curriculum according to the practical character of the program and equip specialists in the field of management with technical and operational skills.
3. Application of the theoretical modules in practice in order to gain expertise through practical cases.
4. The institution shall continue with the collection and development of literature by professionals in the field, suitable for the level of professional education offered by this study program.
5. To guide students towards practical skills and qualifications for the labor market by developing an operational study curriculum.
6. In addition to the internal staff engaged in teaching and research, the engagement of specialized external staff with applied experience in the field of management shall be a priority.
7. Follow up alumni in the labor market to help boost future demand for this program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Notë përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	